

UNIVERSITETI I GJAKOVËS FEHMI AGANI

FAKULTETI I MJEKËSISË

DREJTIMI-INFERMIERI



PUNIM DIPLOME

**TEMA:QËNDRIMI ETIK INFERMIEROR NDAJ
PACIENTËVE NË PSIKIATRI**

Mentori: Prof.Ass. Naim Jerliu

Kandidati: Afërdita Smajli

Gjakovë-2016

FALËNDERIMET

Do të dëshiroja të falënderoja të gjithë ata që kanë dhënë kontributin e tyre, në përmbylljen me sukses të punës sime kërkimore, fryt i një rruge të nisur tre vite më parë.

Dua të falënderoj Universitetin e Gjakovës, Fakultetin e Mjekësisë, dhe profesorët universitar për punën që kanë bërë deri më tani.

Një falënderim i veçantë shkon për mentorin tim, Prof.Ass. Naim Jerliu për ndihmën dhe mbështetjen që më ofroi gjatë gjithë punës sime, deri në finalizimin e punimit të temës së diplomës, për këshillat që më ka dhënë, kryesisht në pjesën e strukturës së punimit. Këshillat e dhëna prej tij me shumë profesionalizëm dhe dashamirësi, në çdo moment të punës sime, më lehtësuan kapërcimin e shumë vështirësive.

Falënderoj familjarët dhe miqtë e mi që më ofruan përkrahje morale dhe financiare.

Faleminderit gjithashtu edhe për anëtarët e komisionit vlerësuesë.

JU FALEMINDERIT TË GJITHËVE

PËRMBAJTJA

Kapitulli - I -

1. Abstrakti.....	04
1.0.Hyrje.....	05
1.1.Shqyrtim i literaturës.....	06
1.2.Etika Infermierore.....	08
1.3.Roli i Infermierëve në Psikiatri.....	10
1.4. Qëndrimet e infermierëve mbi etikën ndaj pacientëve në psikiatri dhe të drejtat e pacientëve psikiatrik	12

Kapitulli - II -

1. Qëllimi i punimit.....	15
2. Metodologjia.....	16
3. Rezultatet.....	17
4. Diskutimet.....	28
5. Përfundimet.....	29
6. Rekomandimet.....	31
7. Rezyme.....	32
8. Summary.....	33
9. Literatura.....	34
10. CV e shkurtër e kandidatit.....	35
11. Aneksi.....	36

ABSTRAKTI

Ky studim ka si qëllim të jap një përshkrim të qartë të koncepteve dhe termave të etikës në sferën e infermierisë. Etika është një fushë shumë e gjerë dhe komplekse, dhe ka qenë gjithmonë një shtyllë kryesore e mjekësisë në të gjitha periudhat e historisë në mbarë botën, njohja dhe studimi i të cilës është shumë e nevojshme gjatë ushtrimit të profesionit për të gjithë punëtorët shëndetësor.

Në fokus të këtij punim është vënë rëndësia e pakontestueshme e etikës në përgjithësi, e cila ka ndikim të gjithanshëm në punën e personelit shëndetësor.

Çështje esenciale e këtij punimi është qëndrimi etik infermior ndaj pacientëve në psikiatri. Në kuadër të kësaj çështjeje, në këtë punim, rëndësi të veçantë i kemi kushtuar njohurive, përvojës dhe qëndrimeve etike të punëtorëve shëndetësor në fushën e psikiatrisë.

Është evidentuar rëndësia dhe roli i pazëvendësueshëm i punëtorëve shëndetësor, në kujdesin ndaj pacientëve psikiatrik, një personel i aftë, i mbikqyrur dhe i motivuar është kushtë për zhvillimin dhe mirëfunksionimin e punës së tyre praktike në institucionet shëndetësore në ofrimin e shërbimeve të nevojshme për plotësimin e nevojave të pacientëve duke i'u përmbajtur gjithnjë normave etike.

Andaj në përgatitjen e punimit të diplomës nuk kam lejuar që punimi im të devijojë nga origjinaliteti, me këtë dëshirojë të theksojë që i gjithë materiali i përfshirë në punim është i cituar dhe i listuar në referenca.

1.0.HYRJE

Çfarë është 'Etika'?

Fjala etikë rrjedh nga greqishtja e vjetër ethos- shprehi, adet dhe ethicos - i moralshëm. Definicioni më i shkurtër është : Etika është shkenca mbi moralin (mos,moris- fjalë latine që do të thotë shprehi, adet). Me moral nënkuptojmë sistemin e normave dhe rregullave të mirësjelljes. “ Etika” dhe “Morali” janë dy terma, të cilat në jetën e përditshme ju referohen zakoneve sociale dhe rregullave të mirësjelljes, e lidhur me atë se çfarë është e drejtë dhe e gabuar, në teori dhe praktikën e sjelljes. Ajo është e fokusuar në fjalë të tilla si: e drejtë, e gabuar, e mirë, e keqe, detyrë. Ajo ka të bëjë me bazën mbi të cilën, njerëzit individualisht ose kolektivisht, vendosin që veprime të caktuara janë të drejta ose të gabuar dhe nese dikush duhet të bëjë diçka ose ka të drejtë për diçka. Etika në radhë të parë, përpiket të kuptojë, se sa të vendosë. Ajo tërhiqet nga praktikat imediate dhe përpiket të zbulojë disa nga qëllimet dhe motivet e një sërë vendimeve morale dhe praktikave, si për individët dhe shoqëritë (Graham Rumbold,1999)¹.

1.1. SHYRTIMI I LITERATURËS

Morali është term me prejardhje nga gjuha latine mos, moris që ka kuptimin e ligjit, të zakonshmes, traditës, mirësjelljes, dëlirësisë, karakterit, natyrës etj. Thuhet se këtë shprehje të parët e kanë shfrytëzuar Ciceroni në veprën e tij De fato (Mbi fatin) dhe Seneka në Epistulae (letra) duke e përkthyer fjalën greke ethikos². Morali, philosophia moralis, funksionon si sistem rregullash që duhen respektuar nga individit për t'u ndihmuar në dallimin e së keqes nga e mira, në dëllimin e detyrimeve e të tjera³. Në kuptimin filozofik fjala moral do të thotë tërësi traditash, sidomos traditash të mira, të cilat mundësojnë ekzistimin dhe zhvillimin e volitshëm dhe harmonik të individit dhe shoqërisë. Fjala moral shpreh edhe përsëritjen e veprave, sjelljeve në kuadër të një sistemi shpirtëror, shprehitë dhe hujet⁴. Sipas Ojvind Larsen termi moral në përgjithësi përdoret për të sqaruar referencat normative të dhëna ose tradicionale, që se humbin vlefshmërinë dhe fuqinë e vet. Dallimi kryesor ndërmjet etikës dhe moralit, koncepte këto shumë të përafërta, qëndron në të qenët e etikës disiplinë që në përgjithësi merret me çështjen e moralit⁵.

Mund të thuhet se etika është sinonim i filozofisë së moralit, ajo për nga definimi ka domethënie më të gjerë dhe më të thellë. Si mësim për moralin, etika paraqet edhe teorinë dhe përmbajtjen e moralit, kurse morali ka të bëjë vetëm me përmbajtjen e jo edhe me teorinë e moralit. Shkurt, përderisa etika shtron norma, te morali normat janë të dhëna.⁶ Për Dwight Waldo, morali nënkupton sjelljen e pëlqyer në kuptimin e menjëhershëm dhe tradicional, kurse etika përbën sjelljet që i kemi ekzaminuar dhe menduar ⁷. Duhet shënuar se ky dallim s'bëhet gjithëherë. Si problemi më themelor në etikë merret përligjja e moralshmërisë, pra nëse mund të vërtetohet apo jo se veprimi moral është i arsyeshëm. Moraliteti është koncept i trajtuar nga filozofë si Hume, Kant, Hegel, të cilët sipas Rawls e përkufizojnë moralitetin si instrumentin e drejtësisë sociale që “është në themele të strukturës së shoqërisë, që jeton përmes mënyrës se si institucionet sociale shpërndajnë të drejtat themelore, përgjegjësitë dhe avantazhet sociale”⁸.

Sokrati ka shtruar pyetjen "Se si duhet të jetojë?". Thelbi i kësaj sfide ishte çështja e një "jetë më të mirë", por më tepër një kuptim thelbësor me vlerë për një jetë.

Për të kuptuar më mire etikën duhet të kuptojmë vlerat nga të cilat ato dalin. E thënë thjesht, çështja e Sokratit është përgjigjur mirë në idenë se për të jetuar një jetë të mirë, duhet për të jetuar në përputhje me një sërë vlerash. Vlerat e tilla mund të shfaqen si pjesë e vlerave më të gjera shoqërore, ose mund të ndërtohen thjesht në rrjedhën e jetës së individit.

Në kujdesin shëndetësor mendor, etika dhe kultura janë të ndërthurura ngushtë. Të praktikosh etike kërkon vetëdije, dhe ndjeshmëri për pacientin si një individ, duke përfshirë edhe vlerat e tij ose të saj kulturore dhe besimet.

Në trajtimin e shëndetit mendor, dilemat etike mund të lindin për shkak të dallimeve në mes të vlerave dhe besimit të një klienti, edhe kur dy individëve kanë të njëjtën trashëgimi kulturore.

Këto dallimet janë në dukje, kur marrëdhënia infermier-klientë ndodhë brenda një mjedis ndër-kulturor.

Grekët e lashtë i dhanë një rëndësi të veçantë vlerës së Etikës dhe Moralit, Sokrati, Platoni dhe Aristoteli u morën në menyrë sistematike me kuptimin e Etikës.

Platoni thotë se:” *Etika është virtyti më i lartë, pasi me anën e saj njerëzit bëhen të lumtur*”.

Irakliti mbështeti idenë se : “*Është forca morale ajo që e qon njeriun drejtë përparimit*”.

Të njohësh të vërtetën e mirë në vetvete është një veprim moral, pra ndjenja për të vërtetën është vetë morali (J. Hersch, 1995).

Individët nuk janë të rëndësishmë në vetvete, por vetëm në faktin se ata janë pjesë e të tërës. Ajo çfarë justifikon veprimet nuk është masa, në të cilën ata përfitojnë individulaisht, por masa, në të cilën ata i shërbejnë qëllimit për të nxitur drejtë një shoqërie socialiste. (Graham Rumbold, 1999)⁹.

Sjellja etike dhe morale i mundëson individit lirinë për instalimin e së drejtës pozitive (M.Dhamo, A.Sulstarova, 2006).¹⁰

Sipas James Rest, sjellja në menyrë të moralshme përfshinë katër komponentë: ndjeshmërinë, gjykimin, motivimin dhe karakteristikat e moralit.

Stigmatizmi- Stigma është një shenjë e turp-it që përcakton një person veç e veç. Kur një person është i etiketuar me sëmundje mendore, ata janë pjesë e një grupi stereotip, qëndrimet negative krijojnë paragjykitime të cilat çojnë në veprime negative dhe diskriminim.

Stigma sjell përvojat dhe ndjenjat e: turp, faj, mungesë shprese, ankth, ngurrimi për të kërkuar dhe / ose të pranojë ndihmën e nevojshme.

Familjet janë të prekur edhe nga stigma, duke çuar në një mungesë të mbështetjes. Për profesionistët e shëndetit mendor, stigma do të thotë se ata vetë janë parë si trajtimet psikiatrike jonormale, të korruptuar ,dhe shpesh shihen me dyshim dhe tmerr.¹¹

¹Brizida Refatllari (Furxhi), Venetike Merkaç, Floreta Kurti,- Etika dhe Deontologjia Mjekësore ,2015, fq.11-13.

²Naser Ramadani - Shëndetsia Publike & Etika,Prishtine 2015, Kapitulli I,fq 117.

³Ekrem Murtezai - Fjalor i filozofisë, Prishtinë, 1995, f. 462.

⁴Sokrat Meksi,Bardhyl Çipi – Etika Mjekësore,Tirane 2013,Kapitulli II,fq 37.

⁵Ali Bulla ç- Historia, shoqëria dhe tradita, Logos-A, Shkup, 2003, f. 263.

⁶Ojvind Larsen - Administration ,Ethics and Democracy, Ashgate Publishing Company, Aldershot, Burlington, USA, 2000, f. 55-72.

⁷.Encyclopedia Britannica - 1993/XI: 414-417. Ethics, Lexico Publishing Group. Retrieved on 2008-03-27

⁸Enciklopedia e përgjithshme e Oksfordit - përkth. Abdurrahim Myftiu e të tjerë, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, 2006, f. 332.

⁹Graham Rumbold, -Ethics in Nursing Practice,1999.

¹⁰Milika Dhamo & Anila Sulstarova - Etika në këshillim, Logoreci, Tiranë, 2006, f. 16.

¹¹Government of Western Australia - Mental Health Commission 2010.

1.2.ETIKA INFERMIERORE

Studimi i etikës ka për qëllim ofrimin e mënyrave të formulimit të përgjigjeve ndaj pyetjeve dhe të udhëzoj veprimet. Ofron një kornizë për zgjidhjen e çështjeve, problemeve dhe kundërthënieve. Kuptimi i teorive etike dhe morale ndihmon për të vendosur në mënyre të drejtë për një veprim. Infermieret në ofrimin e kujdesit shëndetësor duhet të studiojnë etiken për disa arsye: Në punën e tyre të përditshme kanë të bëjnë me probleme që janë të natyrës morale ose etike. Infermieret shpesh nxjerrin në pah pyetje etike, përgjigjet ndaj të cilave, nuk mund të gjinden në ndonjërin nga kodet tradicionale të moralit.

Etika e infermierëve:

- Respekton orarin e punës si dhe qëndrimin në punë,
- Respekton hierarkinë dhe ekipin e tij / e saj si dhe marrëdhëniet në ekip, nëpërmjet dëgjimit, të dialogut dhe pjesëmarrjes së tij / së saj,
- Respekton uniformën e infermier-it / es me bluzë të bardhë ose me pantallona dhe xhaketë, infermieret të kenë flokët e mbledhura duke punuar pa unaza, pa bizhuteri të rënda, këpucë të lehta dhe të sheshta. Gjithashtu edhe paraqitja e jashtme e infermierëve meshkuj të jetë brenda normave të lejuara,
- Vendos pacientin në qendër të aktiviteteve të tij / të saj, për këtë: I shërben të sëmurit, e dëgjon atë nën durim duke përdor teknikat e komunikimit verbal dhe jo verbal dhe duke u përshtatur me pacientin dhe familjarët,
- Ndhmon dhe bashkëbisedon me pacientin që të formulojnë nevojat e tij,
- Analizon dhe vlerëson veprimet që ndërmer dhe rezultatet e pritura tek pacienti;
- Bashkëbisedon me pacientin që të arrijë një zgjidhje sa më të mirë e më të mundur rreth kujdesjeve të tij,
- Respekton kartën e pacientit,

- Bën që pacienti të ketë besim tek infermier-i / ja,
- Realizon sigurinë e pacientit në cilësinë e kujdesjeve,
- Jep llogari tek eprorët e tij / e saj për arritjen e misionëve të tij / të saj, në realizimin e aktivitetit të tij / të saj, të marrëdhënieve në ekip si dhe me punëtorët e tjerë të kujdesjeve (laboratorët, radiologjinë, farmacinë) për cilësinë e kujdesjeve dhe të procedurave,
- Përballon situatat e urgjencës dhe të stresit sipas specifikave të sëmundjeve,
- Respekton rregullat e etikës në punë,
- Mbanë statistika dhe kryen studime statistikore për punën e bërë. ¹²

¹²Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve Sektori i Profesionëve dhe Kualifikimeve Profesionale- Tiranë, 2014, Kapitulli -I- Profesionistë Infermierë, fq.4.

3.0.ROLI I INFERMIERËVE NË PSIKIATRI

Roli i infermierit të shëndetit mendor është të ndihmoj dhe mbështes njerëzit që vuajnë nga probleme të ndryshme të shëndetit mendor dhe familjarët e tyre të përballen me kushtet që krijojnë çrregullimi mendor me qëllim që të jetojnë një jetë më të mirë.

Të gjithë klientet kanë të drejtë të dëgjohen dhe të trajtohen me dinjitet dhe respekt, kanë privatësinë e tyre të mbrojtur, dhe kanë dokumentacionin e tyre që të trajtohen në mënyrë konfidenciale, nga praktikuesit e shëndetit mendor.

Ata përpiqen të mbështesin të drejtat e njerëzve, duke përfshirë pjesëmarrjen efektive për të mbështetur individin, dhe të tjerët të cilët mund të preken nga sëmundja e një anëtarit të familjes.

Detyrat e infermierit të shëndetit mendor janë:

Ofron kujdes për personat me probleme të shëndetit mendor në gjendjen akute ose që vuajnë nga një sëmundje kronike;

Vlerëson situatën dhe bisedon me pacientët rreth problemeve që ata kanë dhe diskuton me ta për planin individual të trajtimit dhe mënyrën më të mirë që ky trajtim mund t'u jepet;

Krijon marrëdhënie me pacientët për të fituar besimin, ndërsa dëgjon dhe shpjegon nevojat e shqetësimit të tyre;

Siguron marrjen e rregullt të mjekimit, manipulimet mjekësore, dhe monitoron rezultatet e trajtimit;

Mbështet pacientët e shqetësuar duke iu përgjigjur në mënyrë jo kërcënuese dhe duke u përpjekur të kuptojë arsyet e shqetësimit të tyre;

Përdor teknika qetësuese për t'i ndihmuar ata të menaxhojnë emocionet dhe sjelljet e tyre;

Përgatit grupet terapeutike (nëse ofrohen të tilla në institucionin ku punon) dhe merr pjesë së bashku me një profesionist tjetër;

Nxitë dhe ndihmon pacientët të marrin pjesë në terapi arti, terapi okupacionale kur kjo gjë është e këshillueshme dhe e mundur;

Organizon aktivitete sociale me qëllim zhvillimin e përmirësimin e aftësive sociale të pacientëve;
Përgatit dhe plotëson dokumentacionin e pacientëve ; Rolet, përgjegjësitë dhe kompetencat bazë të profesionistëve të shëndetit mendor,

Merr pjesë në hartimin e planit individual të trajtimit dhe vlerësimet e rrezikut për pacientët;
Punon me familjarët dhe të afërmit e pacientëve për t'i edukuar ata dhe pacientin në lidhje me problemet e shëndetit mendor;

Siguron që janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore në përputhje me situatën dhe kategorinë e pacientëve;

Ofron dhe promovon një kujdes me qasje ndaj shërimit të sëmundjeve mendore;

Nëse ka trajnimin e duhur, mund të ofrojë këshillim në mënyrë formale ose joformale. Ata mund të ndihmojnë pacientët të mësojnë teknika relaksuese kundër ankthit;

Infermieri mund të kërkojë urgjent mendimin e psikiatrit nëse kushtet e pacientit e kërkojnë këtë gjë. Për shembull nëse infermieri identifikon dhe vlerëson ndryshime të rëndësishme në gjendjen mendore të pacientit ai duhet të kërkojë patjetër rivlerësimin nga psikiatri.¹³



Fig.3.0.Komunikimi me pacientin.



Fig.3.1.Raportet Kolegiale

¹³Rolet, përgjegjësitë dhe kompetencat bazë të profesionistëve të shëndetit mendorë- Republika e Shqipërisë, Ministria e Shëndetësisë, 2013, fq. 4-6.

3.1. Qëndrimet e infermierëve mbi etikën ndaj pacientëve në psikiatri dhe të drejtat e pacientëve psikiatrik

Qëndrimi etik i punëtorëve shëndetësor ndaj pacientëve në psikiatri përfshinë parimet e mëposhtme: konfidencialitetin (fshehtësine profesioanle), marrëdhëniet me pacientët dhe të afërmit e tyre, aftësit komunikuese me pacientët, përkrahja morale, psiqike dhe shpirtërore. Të gjithë profesionistët e shëndetit janë të detyruar të ndjekin një kod të rreptë të etikës.

Me fshehtësi nënkuptojmë njohuritë dhe faktet të cilat nuk duhet t'i tregohen personave tjerë e me këtë të mos lëndohet personaliteti i pacientit. Rëndësia specifike e fshehtësisë qëndron në faktin se aty fillon besimi i pacientit në punëtorët shëndetësor. Punëtorëve shëndetësor i'u është e ndaluar shkëmbimi i informacioneve të pacientit me njerëz të tjerë, si një dështim i etikës mund të ketë pasojë ligjore. Konfidencialiteti i lidhur me jetën private të pacientit duhet respektuar dhe ruajtur nga ana e infermierëve. Pacientët i'u besojnë infermierëve ndaj dhe ata duhet të tregojnë mirësjellje për të ruajtur konfidencialitetin e tyre.

Komunikimi me pacientin është pika kyqe ku merret informacioni për shqetësimet e momentit, historisë psikiatrike si dhe trajtimet e mëparshme.

Krijimi i një marrëdhënie të shëndetshme empatike është një proces i vështirë që kërkon përkujdesje, aftësi të mira komunikuese, cilësi njerëzore e profesionale të rëndësishme, në mënyrë që pacientët të ndjehen komod.

Ndodhë që komunikimi me ta është tejet i vështirë për shumë arsye. Faktorët që ndikojnë negativisht në të kuptuarin e informacionit janë: mosha, gjuha, natyra e sëmundjes, niveli social-ekonomik, shkalla e afinitetit me pacientin, prognoza e sëmundjes, koha në dispozicion gjatë bisedës, etj

Komunikimi i duhur me pacientin është një ndër pjesët e rëndësishme të kujdesit infermior të cilit duhet kushtuar një rëndësi e madhe prej profesionistëve shëndetësor. Infermieret gjithmonë duhet të dijnë të gjejnë fjalët e duhura kundrejtë pacientëve të tyre.

Komunikimi i mirë mes infermierëve dhe pacientëve është thelbësor për arritjen e rezultateve të suksesshme të kujdesit infermior¹⁴

¹⁴*Ornela Xhangolli Dervishi*-Komunikimi infermier-pacient, thelbësor për një shërbim efektiv, Tiranë 2015, fq.1.

Për të arritur këtë, infermierëve u kërkohet ligjërisht dhe moralisht që të ndihmojnë pacientët e tyre, duke treguar mirësjellje, mirësi dhe sinqeritet.

Pacienti përcjellë frikën dhe shqetësimet dhe janë infermierët nga ana tjetër që japin informacionin e saktë, me maturi dhe delikatesë.

Komunikimi është një karakteristikë e brendshme e natyrës njerëzore. Komunikimi ka përmbajtje dhe vlerë. Përmbajtja ka të bëjë me atë që u tha, marrëdhënia konsideron mënyrën se si është thënë. Dështimi në komunikim çon në përfundime negative dhe mbajtjen e qëndrimeve.

Etika ndonjëherë mund të keqkuptohet si një koncept abstrakt filozofik. Megjithatë, thelbi i sjelljes së mirë etike është empatia, punonjësit e shëndetit mendor merren me qenie njerëzore, dhe një kuptim dhe vlerësim për ndjenjat dhe nevojat e personit tjetër mbështet praktikën e mirë.

Përgjegjësia e parë etike e praktikuesit të kujdesit shëndetësor është për të lehtësuar vuajtjet.

Megjithatë, pacienti ka të drejtën e trajtimit: trajtim që synon për të lehtësuar vuajtjet, dhe kështu ka një mundësi të arsyeshme për të kuruar ose të përmirësuar gjendjen e tij/saj mendore. Disa e kanë quajtur këtë të drejtë si "trajtim efektiv", dhe ajo ka qenë objekt i argumentit ligjor.

Pacienti ka gjithashtu të drejtë për përkujdesje (kujdes të duhur) dhe respektin e duhur, prandaj profesionistët shëndetësorë duhet të bëjnë gjithçka në fuqinë e tyre që të mos shkelin dinjitetin apo të drejtat e çdo individ, nuk duhet të lejojnë që dëshirat personale, nevojat, ndjenjat, paragjykimet apo besimet të ndërhyjnë në trajtimin e pacientëve ose mirëqenien.

Profesionistët e shëndetësisë, si ofrues të shërbimeve shëndetësore dhe anëtar të sistemit shëndetësorë janë përgjegjës për dhënien e kujdesit ndaj pacientëve. Ata kanë nevojë për njohuri etike për të menaxhuar situatat e ndryshme, me të cilat përballën gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor në përputhje me kodin etik.¹⁵

Çështje të tjera që trajtojnë drejtpërsëdrejti problemet e kujdesit të klientit janë e drejta për trajtim, e drejta për të refuzuar trajtimin, alternativa më pak kufizuese, dhe përdorimi i kufizimeve dhe izolim.

¹⁵Jinger G. Hoop , Tony DiPasquale , Juan M. Hernandez & Laura Weiss Roberts -Medical College of Wisconsin
Ethics and Culture in Mental Health Care, Ethics & Behavior, 2008

E drejta për Informim- Pacientët informohen në lidhje me trajtimet dhe procedurat në mënyrë që ata mund të marrin vendime personale në lidhje me kujdesin e tyre.

Konfidencialiteti - E drejta e klientit për privatësi sigurohet nga ligjet e shtetit. Para se të dhënat të tregohen, klienti duhet të japë pëlqimin me shkrim. Duke folur për një klientë jashtë kontekstit terapeutik shkel të drejtën e klientit për privatësi.

Zbulimi Legal - Kur ekziston rreziku i vetëvrasjës, vrasje, ose abuzimit të fëmijëve, infermierët mund të shkelin konfidencialitetin e pacientëve.

E drejta për trajtim - Çdo klient i pranuar në një institucion psikiatrik duhet të marrë kujdesin e duhur.

E drejta për të refuzuar trajtimin - Të gjithë klientët kanë të drejtë të refuzojnë trajtimin aq kohë sa ata janë kompetent dhe jo të dëmshme për vetëvetën apo të tjerët.

Alternative më pak kufizuese - Të gjithë klientët kanë të drejtë të marrin trajtim në një mjedis që siguron një nivel të përshtatshëm të kujdesit duke ruajtur lirinë e klientit.

Përdorimi i kufizimeve dhe izolim - Kur një klientë është i dhunshëm dhe përbën një kërcënim për vetën apo të tjerët, stafi mund të vendosë për të përdorur kufizimet apo izolim, këto masa janë përdorur vetëm në raste urgjent.¹⁶

¹⁶Diposkan oleh Yulianti Kusniyah- Aspect Legal Ethic of Mental Health Nursing, 2009

-I- QËLLIMI I PUNIMIT

Qëllimi i këtij studim është të vlerësohen njohuritë, qëndrimet dhe përvojat e infermierëve në lidhje me etikën e kujdesit shëndetësor dhe rregullat ligjore në fushën e psikiatrisë.

Objektivat:

- Të përshkruhet se si etika është çelësi kryesor i infermierëve,
- Të diskutohet etika infermierore ndaj pacientëve në psikiatri,
- Të njihemi me rolin e infermierëve në fushën e psikiatrisë,
- Të vlerësohen raportet mes punëtorëve shëndetësor me pacientët psikiatrik dhe familjarët e tyre,
- Të përshkruhen aftësit e infermierëve për të vlerësuar nevojat e pacientëve,
- Të vlerësohen shkathtësitë e infermierëve në komunikimin me pacientët.

-II- METODOLOGJIA

Është bërë anketimi i infermierëve me anë të pyetësorëve të përbërë nga 10 pyetje. Në studim janë përfshirë gjithsej 12 infermierë të Repartit të Psikiatrisë në Spitalin Rajonal të Gjakovës, 8 infermiere femra dhe 4 infermier meshkuj.

Për anketimin e Infermierëve fillimisht është marrë leje për realizimin e studimit në Repartin e Psikiatrisë nga Infermierja kryesore e repartit dhe gjithashtu është kërkuar edhe pëlqimi i çdo infermieri të përfshirë në studim dhe çdo infermier paraprakishtë është njoftuar me objektivat e hulumtimit dhe është lutur për pjesëmarrje në studim.


Delimitimet – Në këtë studim nuk janë përfshirë personeli mjekësor i Repartit të Psikiatrisë, dhe as personeli infermieror apo mjekësor i Qëndrave të shëndetit mendor.

-III- REZULTATET


Përshkrimi i mostrës së hulumtimit është paraqitur në vazhdim me anë të tabelave dhe grafikoneve.

Tab.1. Moshë e Përsonelit shëndetësor.

Gjinia	F		M	
Moshë	25-35vjet	1	25-35 vjet	/
	35-45 vjet	3	35-45 vjet	3
	45-65 vjet	4	45-65 vjet	1
Gjithsej		8 Inf.		4 Inf.



Graf.1.0. Moshë e Përsonelit shëndetësor




Graf.1.1. Moshë e Përsonelit shëndetësor


Në tabelën 1 dhe grafikonet 1.0 dhe 1.1 kemi paraqitur të dhënat për moshën e personelit shëndetësor që punojnë në repartin e psikiatrisë në qytetin e Gjakovës. Nga këto të dhëna kemi fituar këto rezultate: nga 12 infermierë të anketuar 1 infermier (gjinisë femërore) ose 6% i përket moshës 25-35 vjet, 6 infermierë (3 gjinisë femërore ose 18% dhe 3 gjinisë mashkullore ose 30 %) i përkasin moshës 35-45 vjet, dhe 5 infermierë (4 gjinisë femërore ose 40% dhe 1 gjinisë mashkullore ose 6%) i përkasin moshës 45-65 vjet.

Tab.2.Niveli i kualifikimit.

	F	M
Ndihmës Infermier	4	/
Infermier Bachelor	3	/
Infermier Master	1	4
Gjithsej	8 Infermiere	4 Infermier



Graf.2.0. Niveli i kualifikimit




Graf.2.1. Niveli i kualifikimit

Në tabelën numër dy dhe grafikonet 2.0 dhe 2.1 janë paraqitur të dhënat për nivelin e kualifikimit që e posedojnë Infermierët, ku në bazë të këtyre të dhënave kemi arritur në konstatim se nga gjithsej 12 infermierët e anketuarë, nivelin e kualifikimit Ndhimës infermier e posedojnë 4 infermierë (4 të gjinisë femërore ose 40 %, ndërsa sa i përket gjinisë mashkullore nuk e posedonë asnjë infermier këtë nivel kualifikimi). Ndërsa sa i përket nivelit Infermier Bachelor këtë nivel e posedojnë gjithsej 3 infermierë (3 të gjinisë femërore ose 17%, ndërsa asnjë infermier i gjinisë mashkullore nuk i përket këtij niveli të kualifikimit). Ndërsa nivelin Infermier Master e posedojnë gjithsej 5 infermierë (1 gjinisë femërore ose 6% dhe 4 gjinisë mashkullore ose 38%).

Tab.3. Ushtrimi i Profesionit.

	F	M
Deri në 5 vite	/	/
5 deri në 10 vite	/	/
10 deri në 20 vite	4	1
Më shumë se 20 vite	4	3
Gjithsej	8 Inf.	4Inf.




Graf. 3. Ushtrimi i Profesionit

Në tabelën numër tre dhe grafikonin 3 kemi paraqitur të dhënat në lidhje me atë se që sa kohë e ushtrojnë infermierët profesionin e tyre, dhe nga përgjigjet e tyre kemi fitura këto të dhëna: Deri në 5 vite , dhe 5 deri në 10 vite, asnjë infermier nuk i posedon këto vite të ushtrimit të profesionit të tyre si infermier në fushën e psikiatrisë. Ndërsa nga gjithsej 12 infermierë pjesmarrës në ankim, 5 infermierë i përkasin 10 deri në 20 vite, (4 gjinisë femërore ose 40% dhe 1 gjinisë mashkullore ose 6%), ndërsa më shumë se 20 vite të ushtrimit të profesionit i takojnë 7 infermierë (4 gjinisë femërore ose 40% dhe 3 gjinisë mashkullore ose 14%).

Tab.4. Sipas bindjes suaj, cilat janë njohuritë tuaja lidhur me përgjegjësit etike në fushën e infermierisë psikiatrike.

	F	M
Të larta	6	3
Mesatare	2	1
Të ulëta	/	/
Gjithsej	8 Inf.	4 Inf.




Graf.4. Njohuritë dhe Përgjegjësitë etike

Në tabelën numër katër dhe grafikonin 4 kemi paraqitur të dhënat në lidhje me njohuritë dhe përgjegjësit etike të infermierëve në fushën e psikiatrisë, ku nga të dhënat që kemi arritur ti mbledhim gjatë anketimit të infermierëve me anë të pyetësoreve kemi fituar këto rezultate: Njohuri dhe përgjegjësi etike të larta posedojnë gjithsej 9 infermierë (6 gjinisë femërore ose 52 % dhe 3 gjinisë mashkullore ose 30 %), ndërsa njohuri dhe përgjegjësi etike mesatare posedojnë gjithsej 3 infermierë (2 gjinisë femërore ose 12 % dhe 1 gjinisë mashkullore ose 6%), ndërsa sa i përket njohurive dhe përgjegjësi etike të ulëta asnjëri prej infermierëve nuk i posedon.

Tab.5. Si i keni marrë/ fituar njohuritë tuaj të tanishme në normat etike në punën e infermierisë.

	F	M
Përvoja e punës	2	2
Në studimet universitare	2	1
Në kurse dhe seminare	4	1
Vetvetiu	/	/
Gjithsej	8 Inf.	4 Inf.




Graf.5. Njohuritë e fituara në lidhje me normat etike

Në tabelën numër pesë dhe grafikonin 5 kemi paraqitur rezultatet në lidhje me pyetjen se si infermierët i kanë fituar njohuritë në lidhje me normat etike, dhe në bazë të saj kemi ardhur në përfundim se : Gjithsej 4 infermierë (2 gjinisë femërore ose 12% dhe 2 gjinisë mashkullore ose 12 %) njohuritë në lidhje me normat etike i kanë fituar nga përvoja e punës, ndërsa njohuritë nga studimet universitare i kanë fituar 3 infermierë (2 gjinisë femërore ose 12% dhe 1 gjinisë mashkullore ose 6 %), ndërsa 5 infermierë njohuritë e tyre i kanë fituar nga mbajtja e kurseve dhe trajnimeve (4 gjinisë femërore ose 52% dhe 1 gjinisë mashkullore ose 6%).

Tab.6. Sa shpesh hasni në ndonjë situatë të dilemave etike/morale në punën tuaj.

	F	M
Shumë herë	1	1
Ndonjëherë	6	2
Asnjëherë	1	1
Gjithsej	8 Inf.	4 Inf.




Graf.6. Dilemat etike/morale

Në tabelën gjashtë dhe grafikun 6 kemi paraqitur të dhënat, sa i përket pyetjes se sa shpesh hasin në ndonjë situatë të dilemave etike/morale infermierët në punën e tyre, dhe kemi fituar këto rezultate: Nga 12 infermierët e anketuar 2 prej tyre (1 gjinisë femërore ose 6% dhe 1 gjinisë mashkullore ose 6%) kanë deklaruar se shumë herë ndeshen me situata të dilemave etike/morale në punën e tyre, 8 infermierë (6 gjinisë femërore ose 64% dhe 2 gjinisë mashkullore ose 12%) kanë deklaruar se gjatë punës së tyre ndonjëherë ndeshen me situata të dilemave etike/morale, ndërsa 2 infermierë (1 gjinisë femërore ose 6 % dhe 1 gjinisë mashkullore ose 6 %) janë deklaruar se asnjëherë në punën e tyre nuk ndeshen me situata të dilemave etike/ morale.

Tab.7. Si do ta vlerësonit komunikimin me pacientët psikiatrik nga ana e personelit shëndetësor.

	F	M
Komunikim i duhur	8	3
Komunikim mesatar i duhur	/	1
Komunikim jo i duhur	/	/
Gjithsej	8 Inf.	4 Inf.




Graf.7. Komunikimi pacientë – personel shëndetësor

Në tabelën shtatë dhe grafikonin 7 kemi paraqitur rezultatet sa i përket komunikimit pacientë-personel shëndetësor. Nga gjithsej 12 infermierët pjesëmarrës në anketim 11 prej tyre (8 gjinisë femërore ose 70% dhe 3 gjinisë mashkullore ose 24%), kanë deklaruar se komunikimin pacientë-personel shëndetësor e vlerësojnë si komunikim të duhur, ndërsa komunikimin mesatar të duhur pacientë- personel shëndetësor e ka vlerësuar vetëm 1 infermierë ose 6% (gjinisë mashkullore), ndërsa sa i përket vlerësimit si komunikim jo të duhur nuk është deklaruar asnjë infermierë.

Tab.8. Gjatë punës suaj si infermier a keni pasur ndonjë situatë konflikti me pacientët me sëmundje mendore ose të afërmit e tyre.

	F	M
PO	2	4
JO	6	/
Gjithsej	8 Inf.	4 Inf.




Graf.8. Konfliktet ndërmjet pacientëve psikiatrik ose të afërmit e tyre me Infermierët

Në tabelën tetë dhe grafikonin 8 kemi paraqitur rezultatet në lidhje me konfliktet ndërmjet pacientëve ose të afërmit e tyre me Infermierët gjatë punës së tyre. Nga gjithsej 12 infermierët e anketuar 6 infermierë (2 gjinisë femërore ose 12 % dhe 4 gjinisë mashkullore ose 36 %), kanë deklaruar se PO gjatë punës së tyre kanë pasur situata konflikti me pacientët me sëmundje mendore ose familjarët e tyre, ndërsa 6 infermiere ose 52% (gjinisë femërore) kanë deklaruar se JO gjatë punës së tyre nuk kanë pasur situata konflikti me pacientët psikiatrik ose të afërmit e tyre.

Tab.9. Si do ti vlerësonit raportet ndërmjet pacientëve psikiatrik-personel shëndetësor.

	F	M
Shumë të mira	8	3
Mesatarisht të mira	/	1
Pak të mira	/	/
Aspak të mira	/	/
Gjithsej	8 Inf.	4 Inf.




Graf .9. Raportet pacientë psikiatrik – personel shëndetësor

Në tabelën nëntë dhe grafikun 9 kemi paraqitur të dhënat nga rezultatet e fituara me anë të pyetësorëve, në lidhje se si janë raportet pacientë psikiatrikë- personel shëndetësor. Nga gjithsej 12 infermierë, 11 infermierë (8 gjinisë femërore ose 70% dhe 3 gjinisë mashkullore ose 24%), kanë vlerësuar se raportet pacientë psikiatrik – personel shëndetësor janë shumë të mira, ndërsa 1 infermierë ose 6% (gjinisë mashkullore) raportet pacientë- personel shëndetësor i ka vlerësuar mesatarisht të mira.

Tab.10. Si e vlerësoni barazinë e qasjes në shërbimet e shëndetit mendor.

	F	M
Qasje të barabartë	8	4
Qasje jo të barabartë	/	/
Gjithsej	8 Inf.	4 Inf.




Graf.10.Barazia e qasjes në shërbimet e shëndetit mendor

Në tabelën dhjetë dhe grafikunin 10 kemi paraqitur të dhënat nga rezultatet e fituara në lidhje me barazinë e qasjes në shërbimet e shëndetit mendorë. Të gjithë infermierët e përfshirë në anketim gjithsej 12 (8 gjinisë femërore ose 70% dhe 4 gjinisë mashkullore ose 30%) kanë deklaruar se kanë qasje të barabartë sa i përket barazisë së qasjes në shërbimet e shëndetit mendorë.

Tab.11.Pse kemi nevojë për një model të veçantë të etikës në shërbimet e shëndetit mendor.

	F	M
Problemet etike në shërbimet e shëndetit mendor kërkojnë shqyrtim nëpërmjet filtrave (organizative, social, personal, ligjor)	7	4
Shëndeti mendor ka probleme unike(autoritet mbi të tjerët, përcaktojnë politikën sociale, ndikim ligjor).	1	/
Gjithsej	8 Inf.	4 Inf.



Graf.11. Rëndësia e një modeli të veçantë të etikës në shërbimet e shëndetit mendor

Në tabelën njëmbëdhjetë dhe grafikonin 11, kemi paraqitur të dhënat nga rezultatet e fituara në lidhje me rëndësinë e një modeli të veçantë të etikës në shërbimet e shëndetit mendor. Nga gjithsej 12 infermierë (7 gjinisë femërore ose 70% dhe 3 gjinisë mashkullore ose 24%), kanë deklaruar se rëndësia e një modeli të veçantë të etikës në shërbimet e shëndetit mendor është sepse, problemet etike në shërbimet e shëndetit mendor kërkojnë shqyrtim nëpërmjet filtrave (organizative, social, personal, ligjore) dhe 1 infermiere ose 6% (gjinisë femërore) ka deklaruar se rëndësia e një modeli të veçantë të etikës në shërbimet e shëndetit mendor është sepse, shëndeti mendor ka probleme unike (autoritet mbi të tjerë, përcaktojnë politikën sociale, ndikim ligjor).

-IV- DISKUTIMET

Në hulumtimin e bërë nga studentja e mjekësisë Marta Elena Losa Iglesias me temën *Nurse Attitudes in relation to health care ethics and legal regulations for nursing* në Spanjë, ka fituar këto rezultate sa i përket aspekteve etike në lidhje me njohuritë dhe qëndrimet e infermierëve në fushën e psikiatrisë. Në studim kishtë përfshirë gjithsej 50 infermierë të cilët punonin në spitalin Principado de Asturias në Spanjë.

Në bazë të këtij studimi pjesa më e madhe e infermierëve të përfshirë në studim kanë pranuar se njohuritë rreth problemeve etike dhe ligjore janë shumë të rëndësishme për praktikën e tyre klinike. Megjithatë, ata gjithashtu mendojnë se nuk janë të trajnuar sa duhet në këtë aspekt, dhe shpeshë kanë raportuar që kanë mungesë të njohurive rreth rregullave ligjore. Infermierët në moshë më të re kanë raportuar se posedojnë më shumë njohuri se sa infermierët e moshës më të vjetër, dhe që këto njohuri i kanë fituar në bazë trajnimeve dhe studimeve universitare. Në studimin e saj, ka deklaruar se pothuajse të gjithë infermierët kishin njohuri të moderuar të Betimit të Hipokratit dhe Kodin e Etikës për infermierë, por ata kishin njohuri të dobët në lidhje me Deklarata e Helsinkit dhe Nuremberg Code, edhe pse infermierët ishin në dijeni të kodit të etikës, ata e kishin të vështiri zbatimin e këtij kodi në mjedisin e punës së tyre.

Ndërsa qëllimi i studimit tim ishte të njoftohesha me njohuritë, përvojat dhe qëndrimet që posedojnë infermierët e repartit psikiatrik të spitalit rajonal të Gjakovës, sa i përket etikës si një faktor kyç gjatë ushtrimit të profesionit. Gjatë punës sime hulumtuese në studim me gjithsej 12 infermierë pjesëmarrës, si rezultat është gjetur se infermierët e moshës më të re, sa i përket njohurive rreth etikës kanë pohuar se sipas bindjes tyre ata posedojnë njohuri të larta lidhur me përgjegjësitë etike në fushën e infermierisë psikiatrike, dhe se këto njohuri i kanë fituar nga studimet universitare dhe mbajtja e trajnimeve dhe kurseve të ndryshme, krahas infermierëve të moshës më të vjetër dhe përkundër ushtrimit shumëvjeçar të profesionit tyre, të cilët kanë raportuar se sa i përket njohurive rreth përgjegjësisë të etikës posedojnë njohuri mesatare, dhe se këto njohuri i kanë fituar nga përvoja e punës, dhe kanë shprehë mendimin e tyre që organizimet për trajnime dhe kurse do të jenë të mirseardhur për personel shëndetësor .

-V- PËRFUNDIMET

Nga rezultatet e fituara me anë të studimit hulumtues, sa i përket njohurive, përvojës dhe qëndrimit mbi etikën që posedojnë infermierët e repartit psikiatrik në spitalin rajonal të Gjakovës ndaj pacientëve në psikiatri, si përfundim kemi nxjerr këto konkluzione.

- Sa i përket njohurive rreth etikës, 82 % e infermierëve pjesëmarrës në studim, kryesisht të moshës më të re (35-45 vjet) dhe ata të cilët sa i përket nivelit të kualifikimit i përkasin kualifikimit infermierë bachelor dhe master kanë deklaruar se sipas bindjes tyre ata posedojnë njohuri të larta mbi etikën në fushën e infermierisë psikiatrike, dhe se këto njohuri i kanë fituar në studimet universitare dhe mbajtja e kurseve dhe trajnimeve, ndërsa 18 % e infermierëve kryesisht të moshës më të vjetër (45-65 vjet), dhe që i përkasin kualifikimit infermierë ndihmës, kanë deklaruar se sipas bindjes tyre ata posedojnë njohuri mesatarisht të larta në lidhje me etikën si një faktorë mjaftë i rëndësishme në punën e tyre praktike, dhe se këto njohuri i kanë fituar në bazë të përvojës së punës profesionale.
- Ndërsa sa i përket qëndrimeve etike infermierore ndaj pacientëve me sëmundje mendore, në lidhje me atë se sa shpesh hasin infermierët në situata të dilemave etike/ morale gjatë punës së tyre, 12 % e infermierëve kanë pohuar se shumë shpesh ndeshen me situata të dilemave etike/ morale në punën e tyre profesionale, ndërsa 76% e infermierëve kanë deklaruar se ndonjëherë hasin në situatat të dilemave etike/ morale në ushtrimin e tyre si infermierë në fushën e psikiatrisë dhe 12 % e infermierëve të anketuar kanë pohuara se gjatë veprimtarisë së tyre profesionale asnjëher nuk kanë hasur në situata të dilemave etike/ morale.
- Sa i përket çështjes se si vlerësohet komunikimi pacientë- personel shëndetësor, 96% e infermierëve kanë deklaruar se komunikimin me pacientët psikiatrik e vlerësojnë si komunikim të duhur, dhe 6% e infermierëve ka deklaruar se komunikimi pacientë – infermierë vlerësohet si komunikim mesatar i duhur.
- Ndërsa sa i përket konflikteve ndërmjet punëtorëve shëndetësor me pacientët dhe familjarët e tyre, 48 % e infermierëve kanë pohuar me JO, se gjatë punës së tyre nuk ndeshen me situata konflikti me pacientët ose të afërmit e tyre, dhe 52 % e infermierëve

sa i përket situatave të konflikteve infermierë- pacientë dhe familjarë të tyre kanë pohuar me PO, se gjatë punës së tyre ndeshen me situata konflikte.

- Raportet pacientë- personel shëndetësor, vlerësohen mjaftë mirë nga ana e punëtorëve shëndetësor, ku 94% e infermierëve pjesmarrës në studim kanë deklaruar se raportet me pacientët psikiatrik i vlerësojnë shumë të mira, ku një perqindje e vogël e infermierëve 6%, ka deklaruar se raportet pacientë- infermierë i vlerëson mesatarisht të mira.
- Për nga barazia e qasjes së shërbimeve në shëndetin mendor , këtu shihet se kemi qasje të barabartë për të gjithë pacientët me sëmundje mendore nga ana e personelit shëndetësor, ku të gjithë infermierët e përfshirë në studim ose 100 % e infermierëve kanë deklaruar se barazinë e qasjes së shërbimeve në shëndetin mendor e vlerësojnë si qasje të barabartë.
- Ndërsa sa i përket asaj se: Pse kemi nevojë për një model të veçantë të etikës në shërbimet e shëndetit mendor, nga rezultate e fituar me anë të anketimit të infermierëve të repartit psikiatrik, kemi nxjerr këto përfundime, 94% e infermierëve kanë deklaruar se nevoja për një model të veçantë të etikës në shërbimet e shëndetit mendor është sepse, problemet etike në shërbimet e shëndetit mendor kërkojnë shqyrtim nëpërmjet filtrave (organizative, social, personal, ligjor), dhe 6 % e infermierëve kanë deklaruar se, shëndeti mendor ka probleme unike(autoritet mbi të tjerët, përcaktojnë politikën sociale, ndikim ligjor), prandaj është e nevojshme të kemi një model të veçantë të etikës në shërbimet e shëndetit mendor.

-VI- REKOMANDIMET

- Infermierët të kenë më shumë njohuri rreth shëndetit mendor, sëmundjes mendore dhe shërbimeve të shëndetit mendor;
- Edukimi dhe përgatitja e profesionistëve të shëndetit mendor që do të kontribuojnë në përmirësimin e shëndetit mendor të popullatës;
- Pasi që numri i sëmundjeve mendore është në rritje është mirë të organizohen seminare dhe trajnime të kohë pas kohëshme rreth temave që përkojnë me profesionin;
- Empatia, respekti i ndërsjellë (me pacientë, si dhe familje) dhe angazhimi pozitiv nga secili punëtor shëndetësor, në mënyrë që t'ju shmangën sa më shumë situatave të konflikteve me pacientët me sëmundje mendore dhe familjarët e tyre;
- Përsonele shëndetësor duhet të bashkëpunojë më shumë me pacientët dhe familjarët e tyre dhe të mbështesë njerëzit që vuajnë nga probleme të ndryshme të shëndetit mendor dhe familjarët e tyre të përballen me kushtet që krijon çrregullimi mendor me qëllim që të jetojnë një jetë më të mirë;
- Të punojnë gjithnjë në përputhje me kodin e etikës dhe në zbatim të ligjit;
- Të kenë aftësi për të vlerësuar nevojat e pacientëve;
- Ne të gjithë kemi një rol në krijimin e një komuniteti të shëndetshëm mendërisht që mbështetë shërimin dhe përfshirjen sociale dhe redukton diskriminimin, dhe mënyrat për të ndihmuar në sfidimin e stigmës përfshijnë:
- Të mësojnë dhe të ndajnë faktet në lidhje me shëndetin mendor dhe sëmundjen,
- Të njohin përvojat personale të njerëzve me sëmundje mendore,
- Të flasin kur miqtë, familja, kolegët apo media shfaqin besime të rreme dhe stereotipet negative,
- Të ofrojnë të njëjtën mbështetje për njerëzit kur ata janë fizikisht ose mendërisht të sëmurë,
- Mos etiketimin ose gjykimin e njerëzve me sëmundje mendore, ti trajtojmë ata me respekt dhe dinjitet si gjithë të tjerët,
- Të mos diskriminojnë kur është fjala për pjesëmarrjen, strehim dhe punësim,
- Të flasin hapur për përvojën tuaj të sëmundjes mendore. Sëmundja mendore mbetet e fshehur, sepse shumë njerëz vazhdojnë të besojnë se është e turpshme dhe ka nevojë për tu fshehur.

REZYME

Hyrje - Fjala etikë rrjedh nga greqishtja e vjetër ethos- shprehi, adet dhe ethicos - i moralshëm. Definicioni më i shkurtër është : Etika është shkenca mbi moralin (mos,moris- fjalë latine që do të thotë shprehi, adet).

Qëllimi - Qëllimi i këtij studim është të vlerësohen njohuritë, qëndrimet dhe përvojat e infermierëve në lidhje me etikën e kujdesit shëndetësor dhe rregullat ligjore në fushën e psikiatrisë.

Materiali dhe Metodat - Studimi është i natyrës kualitative, në studim janë përfshirë gjithsej 12 infermierë të repartit psikiatrik në spitalin rajonal të Gjakovës, dhe është bërë anketimi i tyre me anë të pyetësorëve të përbër nga 10 pyetje.

Rezultatet - Infermierët sa i përket njohurive rreth etikës kanë pohuar se sipas bindjes së tyre ata posedojnë njohuri të larta lidhur me përgjegjësit etike në fushën e infermierisë psikiatrike, dhe se këto njohuri i kanë fituar nga përvoja e punës, studimet universitare dhe mbajtja e trajnimeve dhe kurseve.

Përfundimi – etika luan një rol të rëndësishëm në punën profesionale të personelit shëndetësor, ndaj çdo punëtor shëndetësor duhet respektuar dhe punuar gjithnjë sipas normave etike të punës.

Fjalët kyqe – etika profesionale, etika infermierore, roli i infermierëve në psikiatri.

SUMMARY

Entrance -The word ethics originates from the greek old word ethos-a habit,costum and ethicos-The shortest definition is:Ethics is a science upon the morals(mos,moris-a latin word which means a habit, costum.)

The purpose - The purpose of this study is to evaluate the knowledge, attitudes and experiences of the nurses in relationship with the ethics of the health care and the legal norms in the field of psychiatry.

Material and Methods-The study is of a qualitative nature. In total 12 nurses of the psychiatric section have been involved from the regional hospital of Gjakova, alongside with their interrogation by means of the questionnaires consisting of 10 questions.

The Results - According to their knowledge regarding the ethics, the nurses have admitted that according to their convictions they possess a high level of knowledge in the field of psychiatric nursery,and that they have gainrd these informations from the work experience, university studies and the enrolling of trainings and courses.

Conclusion - The ethics plays an important role in the professional work of the health staff, there fore each employer should be respected and he should work as well according to the ethical norms of the work.

Key words - Professional ethics, nursery ethics, the role of nurses in psychiatry.

LITERATURA

1. Brizida Refatllari (Furxhi), Venetike Merhaj, Floreta Kurti,- Etika dhe Deontologjia Mjekësore , 2015, Kapitulli –I- , fq.11-13.
2. Naser Ramadani - Shendetsia Publike & Etika, Prishtine 2015, Kapitulli I, fq 117.
3. Ekrem Murtezai - Fjalor i filozofisë, Prishtinë, 1995, f. 462.
4. Sokrat Meksi, Bardhyl Çipi – Etika Mjekësore, Tirane 2013, Kapitulli II, fq 37.
5. *Ali Bulla ç*- Historia, shoqëria dhe tradita, Logos-A, Shkup, 2003, f. 263.
6. *Encyclopedia Britannica* - 1993/XI: 414-417. Ethics, Lexico Publishing Group. Retrieved on 2008-03-27.
7. *Ojvind Larsen* - Administration ,Ethics and Democracy, Ashgate Publishing Company, Aldershot, Burlington, USA, 2000, f. 55-72.
8. *Enciklopedia e përgjithshme e Oksfordit* - përkth. Abdurrahim Myftiu e të tjerë, Instituti i Dialogut & Komunikimit, Tiranë, 2006, f. 332
9. Graham Rumbold - Ethics in Nursing Practice Vëllimi III, 1999.
10. *Milika Dharmo & Anila Sulstarova* - Etika në këshillim, Logoreci, Tiranë, 2006, f. 16.
11. Government of Western Australia - Mental Helath Commission 2010.
12. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve Sektori i Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale- Tiranë, 2014, Kapitulli -I- Profesionistë Infermierë, fq.4.
13. Rolet, përgjegjësitë dhe kompetecat bazë të profesionistëve të shëndetit mendorë- Republika e Shqipërisë, Ministria e Shëndetësisë, 2013, Kapitulli -I-, fq.4-6.
14. Ornela Xhangolli Dervishi- Komunikimi infermier-pacient, thelbësor për një shërbim efektiv, Tiranë 2015, fq.1.
15. Jinger G. Hoop , Tony DiPasquale , Juan M. Hernandez & Laura Weiss Roberts -Medical College of Wisconsin - Ethics and Culture in Mental Health Care, Ethics & Behavior, 2008.
16. Diposkan oleh Yulianti Kusniyah- Aspect Legal Ethic of Mental Health Nursing, 2009.
17. Marta Elena Losa Iglesias - Nurse attitudes in relation to health care ethics and legal regulations for nursing, 2014.

CV e shkurtër e kandidatit

Të dhënat personale :

Emri dhe mbiemri	Afërdita Malë Smajli.
Gjinia	Femër.
Datëlindja	18.01.1994.
Vendbanimi	Nivokaz – komuna Gjakovë.

Të dhënat e kualifikimit:

Shkolla fillore	“Bajram Sadriu” Berjahë.
Shkolla e mesme e lartë	Mjekësi e Përgjithshme “Hysni Zajmi” Gjakovë.
Universiteti	Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani”.
Fakulteti	Fakulteti i Mjekësisë.
Programi	Infermieri.
Statusi	E rregulltë.

Të dhënat kontaktuese :

Nr.Tel.	045-912-855.
Adresa	Nivokaz.
Emaili	Afra.Smajli@outlook.com.

ANEKSI

Gjinia : F M

Mosha: 25-35 vjet 35-45 45-65

1. Cilin nivel të kualifikimit e posedoni?

- Ndhmës infermier
- Infermier Bachelor
- Infermier Master

2. Që sa kohë e ushtroni këtë profesion ?

- Deri në 5 vite
- 5 deri në 10 vite
- 10 deri në 20 vite
- Më shumë se 20 vite

3. Sipas bindjes suaj, cilat janë njohuritë tuaja lidhur me përgjegjësit etike në fushën e infermierisë psikiatrike?

- Të larta,
- Mesatare,
- Të ulëta.

4. Si i keni marrë/ fituar njohuritë tuaj të tanishme në normat etike në punën e infermierisë?

- Përvoja e punës,
- Në studimet universitare,
- Në kurse dhe seminare,
- Vetvetiu.

5. Sa shpesh hasni në ndonjë situatë të dilemave etike/morale në punën tuaj?

- Shumë herë,
- Ndonjëherë,
- Asnjëherë.

6.Si do ta vlerësonit komunikimin me pacientët psikiatrik nga ana e personelit shëndetësor?

- Komunikim i duhur
- Komunikim mesatar i duhur
- Komunikim jo i duhur

7.Gjatë punës suaj si infermier a keni pasur ndonjë situatë konflikti me pacientët me sëmundje mendore ose të afërmit e tyre?

- PO
- JO

8.Si do ti vlerësonit raportet ndërmjet pacientëve psikiatrik-personel shëndetësor?

- Shumë të mira,
- Mesatarisht të mira,
- Pak të mira,
- Aspak të mira.

9. Si e vlerësoni barazinë e qasjes në shërbimet e shëndetit mendor?

- Qasje të barabartë
- Qasje jo të barabartë

10.Pse kemi nevojë për një model të veçantë të etikës në shërbimet e shëndetit mendor?

- Problemet etike në shërbimet e shëndetit mendor kërkojnë shqyrtim nëpërmjet filtrave (organizative, social, personal, ligjore)
- Shëndeti mendor ka probleme unike (autoritet mbi të tjerë, përcaktojnë politikën,sociale,ndikim ligjor).⁷

Komente shtesë

¹⁷Marta Elena Losa Iglesias- Nurse attitudes in relation to health care ethics and legal regulations for nursing, 2014

